



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.149

24 shtator

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.1224, datë 3.9.2008	Për lejimin e kalimit transit të tri autokolonave dhe trupave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	7343
Vendim i KM nr.1225, datë 3.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, pranë Universitetit të Tiranës, në vitin akademik 2008-2009	7344
Vendim i KM nr.1227, datë 3.9.2008	Për miratimin e rregullores “Për kriteret dhe procedurat për zhvillimin e veprimtarive në fushën e turizmit ujqor”.....	7345
Udhëzim i MF nr.27, datë 23.9.2008	Për procedurat dhe limitet e kryerjes së shpenzimeve, rregullat për mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave, rregullat për mënyrën e mbajtjes dhe evidentimit të shpenzimeve dhe të ardhurave dhe procedurat e kontraktimit të personelit të jashtëm dhe shërbimeve të tjera	7350
Vendim i GJK nr.19, datë 18.9.2008	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.177, datë 4.10.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr.99, datë 8.4.2005 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.374, datë 14.6.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën .	7355
Vendim i GJL nr.1, datë 27.3.2008	Me objekt akuzën për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.....	7360
Vendim i ERE nr.110, datë 16.9.2008	Për licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara	7364
Vendim i ERE nr.111, datë 16.9.2008	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Gen-I Tirana” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike.....	7366

Vendim i ERE nr.112, datë 16.9.2008	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Gen-I Tirana” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të furnizuesit të kualifikuar.....	7367
Kërkesë e METE nr.5343, datë 15.9.2008	Për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme, të tipit: tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe kulturave bujqësore që preken nga “Ndërtimi i nënstacionit 400/220/110 KV Kashar.....	7368

VENDIM
Nr.1224, datë 3.9.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË TRI AUTOKOLONAVE DHE TRUPAVE
USHTARAKE SLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 4 shtator 2008, të 3 (tri) autokolonave dhe trupave ushtarake sllovene, të përbëra, përkatësisht:

- Autokolona e parë, me 19 (nëntëmbëdhjetë) automjete, të cilat përmbajnë armatim, municione dhe materiale ushtarake, si dhe 38 (tridhjetë e tetë) trupa ushtarake.

- Autokolona e dytë, me 25 (njëzet e pesë) automjete, të cilat përmbajnë armatim, municione dhe materiale ushtarake, si dhe 41 (dyzet e një) trupa ushtarake.

- Autokolona e tretë, me 22 (njëzet e dy) automjete, të cilat përmbajnë armatim, municione dhe materiale ushtarake, si dhe 34 (tridhjetë e katër) trupa ushtarake.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përta i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përta i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Autokolonat dhe trupat ushtarake sllovene, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1225, datë 3.9.2008

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, PRANË
UNIVERSITETIT TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë Universitetit të Tiranës, të programeve të mëposhtme të studimit, të ciklit të dytë, sipas fakulteteve:

a) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:

i) Programi i studimit “Biologji mjedisore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në biologji mjedisore;

ii) Programi i studimit “Biologji molekulare”, në përfundim të të cilit lëshohet, diplomë e nivelit të dytë, DND, në biologji molekulare;

iii) Programi i studimit “Fizikë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në fizikë;

iv) Programi i studimit “Bioteknologji molekulare dhe industriale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në bioteknologji molekulare dhe industriale;

v) Programi i studimit “Kimia industriale dhe mjedisore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në kimi industriale dhe mjedisore;

vi) Programi i studimit “Inxhinieria e proceseve kimike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinierinë e proceseve kimike.

b) Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja:

i) Programi i studimit “Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor e turistik”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në gjuhë dhe komunikim ndërkulturor e turistik;

ii) Programi i studimit “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”, në përfundim të të cilit lëshohet, diplomë e nivelit të dytë, DND, në përkthim teknik-letrar dhe interpretim;

iii) Programin e studimit “Gjuhësi”, me profile:

- Gjuhësi e sotme

- Gjuhësi historike.

Në përfundim të këtij programi, do të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në gjuhësi, me profil gjuhësi e sotme;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në gjuhësi, me profil, gjuhësi historike.

c) Në Fakultetin Histori-Filologji:

i) Programi i studimit “Histori”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në histori;

ii) Programi i studimit “Arkeologji”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në arkeologji;

iii) Programi i studimit “Trashëgimi kulturore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në trashëgimi kulturore;

iv) Programi i studimit “Marrëdhënie ndërkombëtare”, në përfundim të të cilit lëshohet, diplomë e nivelit të dytë, DND, në marrëdhënie ndërkombëtare;

v) Programi i studimit “Gazetari”, me profile:

- Marrëdhënie publike;

- Gazetari europiane dhe ndërkombëtare;

- Komunikimi ndërkulturor;

- Marketing mediatik;

- Drejtimi dhe menaxhimi i mediave.

Në përfundim të këtij programi, do të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në gazetari, me profil marrëdhënie publike;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në gazetari, me profil gazetari europiane dhe ndërkombëtare;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në gazetari, me profil komunikimi ndërkulturor;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në gazetari, me profil marketing mediatik;
 - Diplomë e nivelit të dytë, DND, në gazetari, me profil drejtimi dhe menaxhimi i mediave.
- ç) Në Fakultetin e Shkencave Sociale:
- i) Programi i studimit “Përkatësi gjinore dhe zhvillim”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në përkatësi gjinore dhe zhvillim.
2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.
3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore, në vitin akademik 2008-2009.
4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin e Tiranës.
5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1227, datë 3.9.2008

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR
ZHVILLIMIN E VEPRIMTARIVE NË FUSHËN E TURIZMIT UJOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2, shkronja “dh”, e 3, të nenit 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, dhe të neneve 5 e 18 të ligjit nr.9710, datë 10.4.2007 “Për portet turistike në republikën e Shqipërisë”, me propozim të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- 1. Miratimin e rregullore “Për kriteret dhe procedurat për zhvillimin e veprimtarive në fushën e turizmit ujq”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - 2. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
**“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARIVE
NË FUSHËN E TURIZMIT UJOR”**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave që duhet të ndiqen për zhvillimin e veprimtarive në fushën e turizmit ujqor përgjatë vijës bregdetare dhe në ujërat e brendshme të lundrueshme të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2 Subjektet

Subjektet e kësaj rregulloreje janë personat fizikë a juridikë, vendas a të huaj, që ushtrojnë veprimtari të turizmit ujqor.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Veprimtari të turizmit ujqor" është veprimtaria argëtuese e ushtruar nga subjektet, persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, në fushën e turizmit përgjatë vijës së bregdetit dhe ujërave të brendshme, të lundrueshme të Republikës së Shqipërisë.

b) "Stacione plazhi" është veprimtaria turistike e ushtruar nga personat fizikë ose juridikë në strukturat e pozicionuara në breg të plazhit, të liqeneve ose lumenjve, të pajisura për plazh me kabina, dhoma zhveshjeje, shërbime higjienike dhe dushe. Strukturat mund të jenë të pajisura me impiante të tjera dhe pajisje për përgatitjen e pijeve dhe ushqimeve dhe për ushtrimin e aktiviteteve të tjera të lidhura me plazhin, si: banjo dielli, kurat termale, aktivitete sportive dhe argëtuese.

c) "Lundrime turistike" janë lundrimet që kryhen për qëllime argëtuese, zbavitëse, njohëse e sportive.

d) "Mjete për lundrime turistike" janë mjete të caktuara për kryerjen e veprimtarisë turistike dhe të regjistruara si të tilla në regjistrat përkatës sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9251, datë 8.7.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë".

e) "Sporte ujore" janë veprimtaritë argëtuese që zhvillohen nën ujë e mbi ujë duke përdorur mjetet e vogla lundruese (jahte, skafë dhe mjete të tjera lundruese të vogla).

ë) "Kërkesa për ushtrimin e veprimtarive të turizmit ujqor" është kërkesa që i drejtohet ministrit përgjegjës për turizmin për të marrë certifikatë për ushtrimin e veprimtarive të turizmit ujqor.

KREU II LLOJET E VEPRIMTARIVE TË TURIZMIT UJQOR

Neni 4 Veprimtari të turizmit ujqor

Llojet e veprimtarive të turizmit ujqor janë:

1. Stacione plazhi,
2. Lundrime turistike,
3. Sportet ujore (jet ski...etj.).

Neni 5

Kriteret që duhet të përmbushin subjektet për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit

1. Të ketë hapësira të gjelbra ose zona të përbashkëta të cilat të jenë të paktën 1% deri në 5% e sipërfaqes kompleksive të stacionit të plazhit.

2. Hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) në stacionet e pozicionuara në zonat ranore duhet të jetë më e madhe se 2,5 m.

3. Hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) në stacionet në zona shkëmbore duhet të jetë më e madhe se 2 m.

4. Të jetë i pajisur me zonën e ndihmës së shpejtë në shërbim pushuesve.

5. Të jetë i pajisur me telefon publik.
6. Të jetë i pajisur me kontenierë për hedhjen e mbeturinave.
7. Çdo çadër duhet të jetë e pajisur me krevat plazhi.
8. Të ketë 1 dush për çdo 50 çadra.
9. Të jetë e pajisur me shërbime higjienike, të paktën 2 për 50 çadra, nga të cilat 1 për burra 1 për gra.
10. Të reklamojë çmimet për shërbimin e ofruar.
11. Të zbatojë kodin e etikës globale në fushën e turizmit.
12. Çadrat dhe ndenjëset e pushuesve të vendosen jo më afër se 5 m nga bregu.
13. Subjektet që administrojnë stacionin e plazhit përgjigjen edhe për mbajtjen pastër të territorit në administrim.

Neni 6

Dokumentacioni që duhet të plotësojnë subjektet për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit

Çdo subjekt fizik a juridik vendas a i huaj, që kërkon të ushtrojë veprimtarinë e stacionit të plazhit duhet t'i drejtohet ministrit përgjegjës për turizmin dhe duhet të plotësojë këto dokumente:

1. Certifikatën e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
2. Dokumenti ligjor nga organet kompetente për përdorimin e hapësirës për veprimtarinë e caktuar;
3. Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
4. Vërtetim për masat e mbrojtjes nga zjarri lëshuar nga autoritetet shtetërore kompetente;
5. Dokumentin zyrtar për plotësimin e kushteve higjieno-sanitare lëshuar nga autoritetet shtetërore kompetente;
6. Vërtetim nga dega e tatimeve ku subjekti ushtron veprimtarinë.

Neni 7

Kriteret që duhet të përmbushin subjektet për ushtrimin e veprimtarisë së lundrimit turistik

Çdo subjekt që kërkon të ushtrojë veprimtarinë e lundrimit turistik duhet të përmbush kriteret e mëposhtme:

1. Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjeteve të vogla lundruese në regjistrat përkatës sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”;
2. Dëshmi të drejtimit të mjetit të vogël lundrues;
3. Kërkesat e sigurisë për mjetet e vogla lundruese dhe funksionimin e tyre;
4. Certifikatat përkatëse të mjeteve lëshuar nga organet kompetente;
5. Motorrët e ujit nuk lejohet të qarkullojnë më afër se 200 m nga bregu i detit.

Neni 8

Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së sporteve ujore

Çdo subjekt që kërkon të ushtrojë veprimtarinë e sportit ujor duhet të përmbushë kushtet e kriteret e mëposhtme:

1. Certifikatat përkatëse të mjeteve lëshuar nga organet kompetente;
2. Policën e sigurimit për çdo mjet të vogël lundrues për përgjegjësinë civile për klientët dhe për ekuipazhin;
3. Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjeteve të vogla lundruese në regjistrat përkatës sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”;
4. Dëshmi të drejtimit të mjeteve të vogla lundruese;
5. Lista e personelit ndihmës.

Neni 9

Dokumentacioni për ushtrim të veprimtarisë së lundrimit turistik dhe sporteve ujore

Çdo subjekt, fizik a juridik, vendas a i huaj, që kërkon të ushtrojë veprimtarinë e lundrimit turistik dhe sporteve ujore duhet t'i drejtohet ministrit përgjegjës për turizmin dhe duhet të plotësojë këto dokumente:

1. Kërkesën me shkrim drejtuar ministrit përgjegjës për turizmin;
2. Certifikatat përkatëse të mjeteve, lëshuar nga organet kompetente;
3. Certifikatën e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
4. Vërtetim të gjendjes gjyqësore (data e dëshmisë të jetë jo më vonë se tre muaj nga data e dorëzimit të kërkesës për certifikatë);
5. Dokumentin ligjor nga organet kompetente për përdorimin e hapësirës për veprimtarinë e caktuar;
6. Llojet e mjeteve të vogla lundruese që do të përdoren;
7. Polica e sigurimit;
8. Leja e lundrimit.

KREU III

PROCEDURAT PËR MARRJEN E CERTIFIKATËS PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARIVE TË TURIZMIT UJOR

Neni 10

Subjektet që kërkojnë të pajisen me certifikatë për zhvillimin e veprimtarive të turizmit ujor i paraqesin kërkesën me shkrim ministrit përgjegjës për turizmin dhe dokumentacionin shoqërues në përputhje me këtë rregullore.

Kërkesa e subjektit quhet zyrtarisht e dorëzuar, duke filluar nga data e plotësimit të dokumenteve shoqëruese të këtij vendimi.

Struktura përgjegjëse për turizmin në MTKRS shqyrton dokumentacionin dhe njofton subjektin brenda 5 (pesë) ditëve (ditë pune) për plotësimin e tij.

Mbas plotësimit të dokumentacionit dhe verifikimit në vend të mjediseve ku do të ushtrohet veprimtaria, përgatitet raporti vlerësues për ministrin përgjegjës për turizmin, jo më vonë se 15 ditë nga dita e dorëzimit zyrtar të dokumentacionit të kërkuar.

Ministri, me urdhër të veçantë, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga data e dorëzimit të propozimit të strukturës përgjegjëse të turizmit, miraton/refuzon dhënien e certifikatës.

Procesi duhet të përfundojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga dorëzimi zyrtar i dokumentacionit. Kur ka kaluar afati i sipërm dhe subjekti nuk ka marrë asnjë njoftim me shkrim në lidhje me kërkesën e tij, atëherë ai quhet i pajisur me certifikatën. Ministri është i detyruar të lëshojë certifikatën brenda tre ditëve pas përfundimit të këtij afati, në të kundërt subjekti i drejtohet gjykatës.

MTKRS-ja brenda tri ditëve nga urdhri i ministrit për miratimin e certifikatës, njofton zyrtarisht subjektin. Në rastin e refuzimit të kërkesës, subjektit i jepet me shkrim dhe arsyeja e refuzimit.

Afati i vlefshmërisë për certifikatën është 3 vjet.

Neni 11

Heqja e certifikatës për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e turizmit ujor

Personit fizik/juridik privat, të pajisur me certifikatë për të ushtruar veprimtari të turizmit ujor, i hiqet certifikata në rast se:

1. Subjekti nuk respekton kriteret e vendosura në këtë rregullore.
2. Subjekti kërkon të mbyllë këtë lloj aktiviteti për të cilin është pajisur me certifikatë. Në këtë rast subjekti është i detyruar të paraqesë kërkesën me shkrim drejtuar ministrit përgjegjës për turizmin dhe të kthejë dokumentin që i jep të drejtën të ushtrojë veprimtarinë përkatëse në origjinal.
3. Pas heqjes së certifikatës një kopje e urdhrit të ministrit i njoftohet edhe organeve tatimore, ku subjekti ushtron aktivitetin në fushën e turizmit ujor.

Neni 12
Ripërtëritja

Kërkesa e subjektit për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së turizmit ujon ose ripërtëritjen e saj duhet të jetë e shoqëruar detyrimisht me dokumentet origjinale, ose kopje të noterizuara me datë lëshimi jo më vonë se tre muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

Në rastin e kërkesës për ripërtëritjen e certifikatës, përveç dokumenteve të lartpërmendura, duhen paraqitur, gjithashtu në origjinal, edhe dokumenti i mëparshëm që i jepte të drejtën subjektit të ushtronte veprimtarinë në fushën e turizmit ujon.

Dokumentet fiskale (NIPT, certifikatë e regjistrimit në organet tatimore, vërtetim për pagimin e detyrimeve fiskale).

Subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e turizmit ujon duhet të ripërtërijnë certifikatën dyzet ditë para përfundimit të afatit të certifikatës së mëparshme.

Neni 13
E drejta e ankimit

Çdo subjekt aplikues për certifikatë të ushtrimit të veprimtarisë së turizmit detar ka të drejtën e ankimit te ministri përgjegjës për turizmin, në rast të shkeljes së procedurave dhe afateve të vendosura në këtë vendim dhe në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

UDHËZIM
Nr.27, datë 23.9.2008

PËR PROCEDURAT DHE LIMITET E KRYERJES SË SHPENZIMEVE, RREGULLAT PËR MBLEDHJEN DHE ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE, RREGULLAT PËR MËNYRËN E MBAJTJES DHE EVIDENTIMIT TË SHPENZIMEVE DHE TË ARDHURAVE DHE PROCEDURAT E KONTRAKTIMIT TË PERSONELIT TË JASHTËM DHE SHËRBIMEVE TË TJERA

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.968, datë 2.7.2008 “Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”,

UDHËZOJ:

KREU I
SHPENZIMET

1. Shpenzimet për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara janë shpenzime të cilat kryhen gjatë kohës që këto pasuri janë në administrim të Agjencisë. Këto shpenzime kryhen në momentin e shfaqjes së nevojës së kryerjes së shpenzimit dhe janë shpenzime për secilën pasuri më

vete.

2. Shpenzimet për marrjen në dorëzim janë shpenzimet e domosdoshme që kryhen nga Agjencia në funksion të marrjes në administrim të pasurisë dhe përbëhen nga:

a) shpenzimet për udhëtimin dhe dietat e personelit të ngarkuar nga Agjencia për marrjen në administrim;

b) shpenzimet për pagesat e pajisjeve treguese, ndërrimin e bravave (dryna, kyçe etj.), çmontimeve, montimeve, transportit të ngarkesave të mallrave/pajisjeve, magazinimin;

c) shpenzimet për komisione bankare.

3. Shpenzimet e ruajtjes janë shpenzime për pagesat e shërbimit të ruajtjes fizike të pasurive. Për ruajtjen e pasurive, Agjencia do të përdorë shërbimin e ruajtjes së objekteve për të cilat kontraktin paraprakisht subjekte të licencuara e të specializuara për këtë qëllim. Kontrata e shërbimit është 1-vjeçare dhe kontraktori i kryen shërbimet sipas kërkesës së Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Procedura për përzgjedhjen e kontraktorit do t'i referohet pikës 4.b të kreut IV të rregullores së prokurimit publik, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 10.1.2007.

4. Shpenzimet e sigurimit të domosdoshëm janë shpenzimet për pagesën e policave të sigurimit të domosdoshëm të ofruar nga kompanitë e sigurimit në bazë të legjislacionit në fuqi mbi sigurimin e pasurisë. Sigurimi i pasurisë bëhet për çdo njësi pasurie. Vlera për t'u siguruar do të caktohet duke iu referuar raportit të ekspertit vlerësues. Për pasuritë e paluajtshme, vlera për t'u siguruar do të jetë jo më e vogël se vlera e referencës së dhënë në udhëzimet në fuqi të Ministrit të Financave mbi tatimin e shitjes së pasurive të paluajtshme.

5. Shpenzimet e mirëmbajtjes janë shpenzimet e domosdoshme që kryhen për ruajtjen e pasurisë nga shkatërrimi, dëmtimi apo faktorë të tjerë dhe që kushtëzohen nga ruajtja e gjendjes fizike të pasurisë ashtu siç është marrë në dorëzim.

6. Shpenzime për mundësimin e veprimtarisë në ato pasuri, të cilat mund të gjenerojnë të ardhura janë:

a) shpenzimet për instalime dhe riparime të domosdoshme,

b) shpenzimet për botimin e njoftimeve të qirasë, njoftimeve të shitjes, kërkesave për shprehje interesi, njoftimeve të tjera që kanë lidhje me pasurinë,

c) shpenzimet për mbikëqyrjen dhe kontrollin administrativ të aktivitetit të këtyre pasurive, ku përfshihen udhëtime e dieta, kancelari e pajisje të tjera komunikimi,

d) shpenzimet për pagesat e detyrimeve fiskale në ngarkim të pasurisë, sipas legjislacionit në fuqi,

e) shpenzimet për pagesat e energjisë, ujit.

7. Shpenzimet për pagesën e administratorit të pasurisë dhe të personelit ndihmës përbëhen nga:

a) Paga e administratorit të pasurisë dhe e personelit ndihmës, nëse ka të tillë, të kontraktuar nga Agjencia;

b) Shpenzimet e kryera nga administratori i pasurisë, si: udhëtime e dieta, shpenzime të tjera administrative.

8. Shpenzimet për pagesën e shërbimeve të ekspertizës dhe këshillimit teknik përbëhen nga:

a) pagesat për ekspertët e vlerësimit të pronave dhe ekspertët kontabël,

b) pagesat për konsulencë tekniko-ekonomike.

9. Për kryerjen e çdo shpenzimi, administratori i pasurisë miraton kërkesën për kryerjen e shpenzimit te kryeadministratori i Agjencisë. Formulari i kërkesës për shpenzime është ai i aneksit 1, bashkëlidhur. Shpenzimet e përmendura në pikat 2.a dhe 6.c të kreut I kërkojnë nga personat e autorizuar dhe miratohen nga administratori. Ato bëjnë pjesë në shpenzimet e administrimit dhe raportohen nga administratori i pasurisë si shpenzime për pasurinë.

10. Limitet për procedurat e kryerjes së shpenzimeve janë ato të përcaktuara në legjislacionin në fuqi mbi prokurimin publik.

KREU II

RREGULLAT PËR MBLEDHJEN DHE ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE

1. Të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara janë:

a) të ardhurat nga dhënia me qira e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara;
b) të ardhurat nga interesat bankarë të depozitave të siguruara nga të ardhurat e përmendura në seksionin (a) më sipër.

2. Të ardhurat nga pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara depozitohen në një llogari rrjedhëse me emërtimin “Të ardhura e shpenzime për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara në administrim të AAPSK”, të çelur nga Agjencia në një bankë të nivelit II.

3. Të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara përdoren nga AAPSK vetëm për qëllime të shpenzimeve për këto pasuri.

4. Të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nuk mund të përdoren për paga apo shpërblime të personelit të brendshëm të Agjencisë.

5. Në fund të çdo viti financiar, në vartësi të nevojave të Agjencisë, Ministri i Financave mund të vendosë që një sasi e të ardhurave të siguruara nga administrimi i pasurive të kalojnë në Buxhetin e Shtetit.

KREU III

KRITERET DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN ME QIRA TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

1. Agjencia do të përdorë dhënien me qira si formën kryesore të sigurimit të të ardhurave nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

2. Procedurat e dhënies me qira ndjekin parimet e përgjithshme dhe ecurinë e tregut të lirë dhe janë si më poshtë:

2.1 Caktimi i çmimit të qirasë. Për caktimin e çmimeve të dhënies me qira kryeadministratori ngre rast pas rasti një komision për vlerësimin e tregut. Komisioni përbëhet nga administratori i pasurisë dhe 2 përfaqësues të AAPSK-së.

2.1.1 Komisioni bën vlerësimin e tregut duke u bazuar në: - vlerësimin e ekspertit vlerësues, nëse ka të tillë,

- çmimet e aplikuar në zonën përreth pasurisë së sekuestruar,
- çmimet zyrtare për objekte të së njëjtës natyrë,
- kushtet dhe rrethanat në të cilat ndodhet pasuria.

2.2 Lidhja e kontratës së qirasë. Menjëherë pas caktimit të çmimit të qirasë, në rast se pranë Agjencisë ka shprehje interesi për marrjen me qira, kryeadministratori do të lidhë kontratën e qirasë për pasurinë/të. Nëse e konsideron të nevojshme dhe pasi vlerëson leverdisshmërinë e shpenzimit, Agjencia do të përdorë të gjitha format e mundshme të publikimit për njoftimet e qirasë.

2.2.1 Kontrata e qirasë është kontrata tip e qirasë e miratuar nga Ministri i Financave me urdhrin nr.53, datë 20.3.2008. Kryeadministratori i Agjencisë lidh kontratën e qirasë me atë subjekt juridik/fizik, i cili ka paraqitur i pari një shprehje interesi me shkrim për marrjen me qira. Nëse lidhja e kontratës me subjektin që është paraqitur i pari dështon, procesi vazhdon me të dytin e kështu me radhë, deri në lidhjen e kontratës.

2.3 Kontrata me çmim më të ulët sesa çmimi i vlerësuar. Në kushtet e mungesës së kërkesës së tregut për qiramarrje, administratori i pasurisë i kërkon kryeadministratorit të Agjencisë miratimin për aplikimin e çmimeve më të ulëta sesa çmimet e dhëna nga komisioni. Kryeadministratori mund të miratojë çmime më të ulëta të qirasë ose mund t'i kërkojë Ministrit të Financave miratimin për dhënien me huapërdorje të pasurisë, duke i paraqitur argumentet përkatëse.

KREU IV

RREGULLAT PËR MËNYRËN E MBAJTJES DHE EVIDENTIMIT TË SHPENZIMEVE DHE TË ARDHURAVE

1. Të gjitha shpenzimet e përmendura në kreun I të këtij udhëzimi do të përballohen nga të ardhurat e depozituara nga Agjencia në llogarinë “Të ardhura e shpenzime për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara në administrim të AAPSK-së”.

2. Kur llogaritë e përmendura në pikën 1 të kreut IV nuk mjaftojnë, shpenzimet përballohen

nga buxheti i Agjencisë.

3. Për çdo pasuri mbahet në mënyrë analitike kartela, ku evidentohen të ardhurat dhe shpenzimet e kësaj pasurie. Kartela mbahet nga administratori i pasurisë dhe raportohet në Agjenci sipas kërkesës së kryeadministratorit. Forma e kësaj karteje jepet në aneksin 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

4. Agjencia mban në bilancin e saj shifrat e miratuara në planin e buxhetit të miratuar nga Ministri i Financave.

6. Të ardhurat dhe shpenzimet për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara evidentohen dhe mbahen jashtë bilancit të Agjencisë dhe raportohen sipas planit të raportimit të miratuar në planin vjetor të punës dhe buxhetit.

7. Vlerat monetare të sekuestruara/konfiskuara *cash* ose në numra llogarie të subjekteve do të mbahen dhe evidentohen jashtë bilancit të Agjencisë.

KREU V

PROCEDURAT E KONTRAKTIMIT TË PERSONELIT TË JASHTËM DHE SHËRBIMEVE TË TJERA PËR PASURITË E SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

1. Agjencia mund të kontrakttojë administratorë për administrimin e një ose më shumë pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, duke u mbështetur në kushtet e mëposhtme:

- Kërkesat e veçanta të pasurisë, madhësia, volumni i punës, vendndodhja etj.
- Efektshmëria dhe fizibiliteti i caktimit të administratorit.
- Raste të tjera me kërkesë të posaçme të gjykatës.

2. Pagesa e administratorit të pasurisë negociohet mes kryeadministratorit dhe kandidatit përkatës dhe do të mbështetet në:

- volumnin e punës,
- natyrën e veçantë të pasurisë/ve që jepen në administrim dhe vështirësisë,
- nivelin e pagesës së administratorëve të Agjencisë.

2. Kontraktimi i administratorëve të pasurisë. Administratorët e pasurive të sekuestruara, në kuadër të masave kundër financimit të terrorizmit, kontraktohen nga kryeadministratori i Agjencisë. Për kontraktimin e administratorëve të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, në kuadër të luftës për parandalimin e krimit të organizuar, Agjencia i propozon gjykatës emrin e administratorit dhe lidh kontratën me administratorin e caktuar prej gjykatës.

1.2.1. Për vendimet e gjykatës deri në daljen e këtij udhëzimi, të cilat caktojnë Agjencinë si administrator të pasurisë, administratorët kontraktohen direkt nga kryeadministratori, i cili njofton gjykatën për këtë veprim.

3. Për kryerjen e matjeve, vlerësimeve teknike, ekspertizave kontabël apo ekspertizave të tjera sipas rastit, Agjencia do të kontrakttojë persona apo subjekte të licencuara.

4. Procedurat e lidhjes së kontratave me subjektet e përmendura në pikën 3 më sipër janë ato që parashikon legjislacioni për prokurimin publik në fuqi.

KREU VI

DISPOZITA TË TJERA

1. Administrimi i llogarive dhe çdo aktivitet tjetër i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është subjekt i auditimit të Drejtorisë së Auditimit të Ministrisë së Financave.

2. Udhëzimi nr.12, datë 27.2.2008 “Për mënyrat dhe procedurat e dhënies me qira të pasurive të paluajtshme të sekuestruara në kuadër të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, udhëzimi nr.13, datë 27.2.2008 “Për çeljen dhe mënyrat e funksionimit të llogarive likuiduese të të ardhurave dhe shpenzimeve për administrimin e pasurive të paluajtshme të sekuestruara në kuadër të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, shfuqizohen.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Aneksi 1

FORMULARI I KËRKESËS PËR SHPENZIME PËR PASURINË

Kërkesa nr. _____

Datë:

Emërtimi i pasurisë	Statusi	Nr.index.	Nr.kartelës

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Njësia	Shënime
1				
2				
3				
4				

KOSTOJA E PRITUR E SHPENZIMIT (LEKË)	
LLOGARIA NGA DO TË KRYHET SHPENZIMI	
DATA KUR KËRKOHET KRYERJA E SHPENZIMIT	

Administratori i pasurisë
(emri, mbiemri, firma)

Administratori i AAPSK-së
(emri, mbiemri, firma)

Miratohet
Kryeadministratori

Aneksi 1

FORMULARI I KARTELËS SË PASURISË

Nr.kartelës _____

Data e çeljes: __/__/__

Subjekti	Emërtimi i pasurisë	Nr.index.	Nr.dosjes

Nr.	Përshkrimi i veprimit	Dt.veprimit	Shpenzime	Të ardhura	Gjendja		Kolona 3	
					D	K	Llog.pasurive	Buxh.AAPSK

	1	2	3	4	5	6	7	8
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
	Shuma							

Shënime

Administratori i pasurisë

Administratori i AAPSK-së

VENDIM
Nr.19, datë 18.9.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Gjergji Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datën 2.4.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.60/14 Akti, që i përket:

KËRKUES: THOMA SHKURTI, përfaqësuar nga avokate Fatmira Luli, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga Artur Selmani, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.177, datë 4.10.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr.99, datë 8.4.2005 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.374, datë 14.6.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f e 134 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi, përfaqësuesen e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari Thoma Nikolla Shkurti, i datëlindjes 1977, ka lindur dhe është banues në

Bishtanakë, Fier. Ai fillimisht ka qenë me emrin Armand, por në 26 korrik 2002 e ka ndryshuar emrin e tij në Thoma me vendimin nr.48, datë 26.7.2002 të këshillit bashkiak Fier.

Në 26 shkurt 2003, shtetasja L.A., e kthyer nga Italia në portin e Durrësit, ka bërë kallëzim penal ndaj kërkuesit dhe babait të saj, duke i akuzuar se të dy kishin vepruar në bashkëpunim me qëllim për shfrytëzim prostitucioni.

Në datë 3 mars 2003, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal nr.120 ndaj shtetasit Armando Shkurti, i biri i Fuatit dhe Dashuries, i lindur në vitin 1975 dhe banues në lagjen "Sheq i Vogël" Fier.

Në datë 18 mars 2003, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka marrë vendimin nr.55 për sigurimin e provës së dëshmisë së dhënë nga L.A. në prani të avokatit të caktuar kryesisht, pasi i pandehuri Armando Shkurti nuk u gjet në banesën e tij. Avokati i caktuar kryesisht nuk e ka ankimuar vendimin për sigurimin e provës brenda afatit, prandaj ky vendim ka marrë formë të prerë.

Gjatë procesit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, sipas nenit 40 pika 3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka bërë ndreqjen e identitetit të të pandehurit me vendimin e datës 29.5.2003 dhe në datë 2 shtator 2003 ka dërguar për shqyrtim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier çështjen ndaj kërkuesit Thoma Nikolla Shkurti.

Me vendimin nr.177, datë 4.10.2004, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur të deklarojë fajtor kërkuesin për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese (shtetasja L.A. ishte e mitur në kohën kur është shfrytëzuar për prostitucion), si dhe për veprën penale të falsifikimit të pasaportave dhe e ka dënuar me 12 vjet burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.99, datë 8.4.2005 dhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.374, datë 14.6.2006.

2. **Kërkuesi** pretendon se vendimet e mësipërme të kundërshtuara janë rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor në këto drejtime:

1) Është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.54, datë 14.3.2003, ka paragjykuar fajësinë e të dyshuarit, duke pranuar kërkesën e prokurorit dhe caktuar masën e sigurimit arrest në burg. Në këtë rast mungonte dyshimi i arsyeshëm bazuar në prova, pasi nuk është bërë identifikimi i personit sipas nenit 295/1 të Kodit të Procedurës Penale.

- Para deklarimit të mungesës së të pandehurit, nuk është bërë njoftimi i akuzës në banesë sipas nenit 140/1 i Kodit të Procedurës Penale. Nuk është bërë shqyrtimi i provës së vetme - shpjegimet e shtetasës L.A. - të paraqitura nga prokurori.

- Gjykatat kanë pranuar provat e akuzës pa u debatuar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

2) Është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe i të drejtës së mbrojtjes efektive, dhe kërkuesi është deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme:

- Kryerja e hetimeve dhe gjykimit është bërë mbi akte të pavlefshme; veprimet hetimore, ngritja e akuzës dhe dërgimi i çështjes në gjykim janë bërë pa dijeninë e kërkuesit dhe për një person me identitet tjetër; ky vendim, nuk është ankimuar nga mbrojtësi i caktuar kryesisht.

- Me vendimin nr.55, datë 18.3.2003, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier i ka cenuar kërkuesit të drejtën e ankimit kundër këtij vendimi, pasi ajo ka caktuar marrjen e provës në seancë gjyqësore pa njoftuar më parë kërkuesin ose familjarët e tij.

- Gjykatat kanë pranuar provat e akuzës pa u debatuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku ato marrin vlerën e provës; kanë pranuar dhe cituar në vendimet e tyre shpjegimet e dëshmitares L.A. si të vërteta, pa u ballafaquar, verifikuar dhe vlerësuar me provat e tjera të administruara në gjykim.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, kërkoi përpara Gjykatës Kushtetuese rrëzimin e kërkesës duke parashtruar:

- Parimi i prezumimit të pafajësisë nuk lidhet në thelb me procedurat që ndjek gjykata në marrjen e vendimit. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në të cilën është vendosur masa e sigurimit arrest në burg ndaj kërkuesit, është dhënë nga një gjyqtar tjetër nga ai i cili ka dhënë vendimin e fajësisë.

- Fakti se të dhënat e dëshmitares L.A. nuk lidheshin me shtetasin Armando Fuat Shkurti, por me shtetasin Thoma Nikolla Shkurti, ka rezultuar vetëm pas përfundimit të seancës së sigurimit të provës. Kjo situatë, *de jure*, ngjan me sigurimin e provës kur organi i akuzës nuk e njeh autorin e

veprës penale. Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon automatikisht pavlefshmëri absolute të provave të marra nga organi i akuzës apo gjykata pa praninë e autorit të veprës penale kur organi i akuzës nuk e ka zbatuar drejt diskrecionin e tij për fillimin e ndjekjes penale.

- Procesi është i rregullt kur gjykatat e faktit i japin të gjykuarit mundësinë e plotë për të kundërshtuar apo ballafaquar në mënyrë efektive provat e paraqitura nga akuza dhe të vendosura në themel të vendimit nga gjykata. Kërkuesit i është dhënë mundësia e plotë nga gjykatat për të paraqitur provat që ai ka vlerësuar se kundërshtojnë akuzën e ngritur ndaj tij.

II

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) i vlerëson pretendimet e kërkuesit në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, se me çfarë detyrimesh i ngarkon gjykatat respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë, barazisë së armëve dhe mosdeklarimit fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

1. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë

Kërkuesi pretendon cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, sepse ka paragjykuar fajësinë e të dyshuarit duke pranuar kërkesën e prokurorit dhe caktuar masën e sigurimit arrest në burg pa bërë verifikimet e nevojshme nga gjykatat, të cilat kanë pranuar provat e akuzës pa u debatuar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Përfaqësuesi i Prokurorisë parashtrroi se kërkuesi nuk e ka argumentuar pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë nga gjykatat; prezumimi i pafajësisë lidhet me kushtet e parashikuara në nenin 30 të Kushtetutës dhe se parimi i prezumimit të pafajësisë nuk lidhet në thelb me procedurat që duhet të ndjekë gjykata në marrjen e vendimit.

Gjykata rithekson se parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Ky parim parashikohet nga neni 30 i Kushtetutës, sipas të cilit “Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”. Gjykata është shprehur edhe më parë se parimi i prezumimit të pafajësisë do të thotë që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 9-2004*).

Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është shprehur se prezumimi i pafajësisë kërkon, ndër të tjera, që kryerja e detyrave nga anëtarët e një gjykate nuk duhet të fillojë me idenë e paracaktuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet, se barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të të akuzuarit. Është detyrë e prokurorit që të informojë të akuzuarin për çështjen kundër tij, në mënyrë që ai të mund të përgatisë e paraqesë mbrojtjen dhe të kundërshtojë provat të cilat mjaftojnë për ta dënuar atë. Parimi i prezumimit të pafajësisë mund të shkelet edhe në mungesë të një deklarimi formal; mjafton të ekzistojë një arsyetim, i cili të sugjerojë se gjykata e konsideron të akuzuarin si fajtor, si edhe kur barra e provës kalon nga prokurori te mbrojtja (*Shih vendimet e GJEDNJ Minelli kundër Zvicrës; John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 shkurt 1996; Telfner kundër Austrisë 20 qershor 2001*).

Bazuar në materialet e dosjes gjyqësore, Gjykata çmon se nuk ekziston ndonjë e dhënë, e cila tregon që anëtarët e gjykatave të zakonshme që kanë shqyrtuar çështjen ta kenë filluar procesin me idenë e paracaktuar se kërkuesi e ka kryer veprën penale. Dosja gjyqësore nuk përmban ndonjë fakt apo rrethanë që të dëshmojë se anëtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të Gjykatës së Apelit Vlorë apo Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë e kanë konsideruar të akuzuarin fajtor para dhënies së një vendimi përfundimtar për fajësinë e tij. As vendimi për masën e sigurisë arrest me burg të kërkuesit dhe ai lidhur me sigurimin e provës nuk përmbajnë deklarata ose arsyetime, të cilat, në një apo tjetër mënyrë, të çojnë në përfundimin se këto gjykata e kanë konsideruar kërkuesin si fajtor. Gjykata çmon, gjithashtu, se gjykatat e zakonshme nuk e kanë kaluar gjatë procesit barrën e provës nga prokurori tek i pandehuri.

Përsa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk i është cenuar parimi i prezumimit të

pafajësisë si element i procesit të rregullt ligjor në bazë të nenit 42 të Kushtetutës.

2. Lidhur me pretendimin se është shkelur parimi i barazisë së armëve dhe se i pandehuri është deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

Kërkuesi pretendon se gjykatat e zakonshme kanë shkelur parimin e barazisë së armëve, pasi ai ose mbrojtësi i tij nuk kanë qenë të pranishëm në procesin gjyqësor për sigurimin e provës së dëshmisë së dhënë nga dëshmitarja L.A., si dhe kur gjykatat kanë rrëzuar të gjitha kërkimet në gjykim të bëra nga mbrojtja për të zbuluar të vërtetën përmes pyetjes së dëshmitarëve, ballafaqimit të tyre, ripyetjes së dëshmitares kryesore të procesit.

Përfaqësuesi i Prokurorisë ka kundërshtuar pretendimet e kërkuesit, duke parashtruar se, që një proces të jetë i rregullt, mjafton që gjykatat e faktit t'i kenë dhënë të gjykuarit mundësinë e plotë për të kundërshtuar apo ballafaquar në mënyrë efektive provat e paraqitura nga akuza dhe të vendosura në themel të vendimit nga gjykata; kërkuesit i është dhënë mundësia e plotë nga gjykatat për të paraqitur provat që ai ka vlerësuar se kontestojnë akuzën e ngritur ndaj tij.

Gjykata thekson se, veçanërisht, në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, e garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Për respektimin e këtyre elementeve, gjykatat duhet të përmbushin me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave rëndësi të veçantë paraqet, sipas rastit, edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij. Është detyrë e shtetit që të marrë masat e duhura për të garantuar pjesëmarrjen në procesin penal të personit të akuzuar ose mbrojtësit ligjor, qoftë edhe atij të caktuar kryesisht (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19-2003*).

Në kuptim të kontrollit kushtetues të procesit të rregullt ligjor sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykata rithekson se pranimi i provave bëhet si rregull nga gjykatat e zakonshme, kurse detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshi edhe mënyrën në të cilën është marrë prova, ka qenë i rregullt (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.7-2005*). Këtë qëndrim mban edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në një sërë çështjesh paraqitur para saj (*Shih vendimin e P.S. kundër Gjermanisë, 4 shtator 2002; Balliu kundër Shqipërisë, 16 qershor 2005*).

Gjykata, në qëndrimet e saj, ka evidentuar në një proces ligjor dallimin që ekziston ndërmjet mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre. Ajo është shprehur se vlerësimi i provave mbetet një çështje për t'u trajtuar nga vetë gjykatat e zakonshme dhe nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit mund dhe duhet të investohet, kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët dhe mënyrat e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor, e aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete (*Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 95-2001, nr.7-2005*).

Gjykata është shprehur edhe më parë se provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.7-2005*). Por mund të ndodhë që të dhënat për veprën, për shkak të natyrës së tyre, të ndryshojnë ose të zhduken. Për pasojë, paraqitja e tyre në gjykim bëhet e pamundur. Me qëllim që të ruhet vlera e të dhënave të konstatuara gjatë hetimeve paraprake, është pranuar instituti i sigurimit të provës, në bazë të të cilit, në rastet e parashikuara me ligj, prova formohet në këtë fazë të procedimit nëpërmjet marrjes së saj nga gjykata sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.

Lidhur me përdorimin e deklaratave si prova të marra në fazën para shqyrtimit gjyqësor, GJEDNJ-ja është shprehur se përdorimi i këtyre deklaratave nuk është gjithmonë jo në përputhje me nenet 6(3)(d) dhe 6(1) të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, me kusht që të drejtat e mbrojtjes të jenë respektuar (*Shih vendimin Windisch kundër Austrisë, i 27 shtator 1990, paragrafi 26*). Kjo gjykatë mban qëndrimin se të gjitha provat normalisht duhet të prodhohen në një seancë publike, në prani të të akuzuarit, me qëllim që të paraqiten argumentet e kundërta. Por ka përjashtime

nga ky parim, përjashtime të cilat nuk duhet të vijnë në kundërshtim me të drejtën e mbrojtjes. Si rregull i përgjithshëm, i akuzuari duhet të ketë një mundësi të përshtatshme dhe të vërtetë për të kundërshtuar dhe pyetur një dëshmitar kundër tij, ose kur ai bën deklarin e tij ose në një fazë të mëvonshme (*Shih vendimet e GJEDNJ P.S. kundër Gjermanisë, 4 shtator 2002, paragrafi 2; Balliu kundër Shqipërisë, 16 qershor 2005 paragrafi 42*). Parimet e procesit të rregullt kërkojnë që interesat e mbrojtjes të balancohen me ato të dëshmitarëve ose viktimave të thirrur për të dëshmuar, veçanërisht kur bëhet fjalë për jetën, lirinë ose sigurinë e një personi (*shih vendimin e GJEDNJ, Doorson kundër Holandës, 26 mars 1996, paragrafi 70*).

Në rastin në shqyrtim, duke pasur parasysh elementet që pretendohen nga kërkuesi se e kanë bërë procesin penal ndaj tij të parregullt, si edhe pozitën e dëshmitares L.A. në këtë proces, Gjykata duhet të vlerësojë nëse kërkuesit i është dhënë mundësia e duhur për të ushtruar të drejtat e tij për t'u mbrojtur nga akuzat për shfrytëzim prostitucioni, përfshi edhe provat e dhëna nga dëshmitarja L.A., sipas kuptimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Këtë vlerësim, Gjykata e kryen duke vështuar procesin penal ndaj kërkuesit në tërësinë e tij.

Bazuar në materialet e paraqitura nga kërkuesi, si edhe nga dosja gjyqësore, Gjykata vëren se në kohën e sigurimit të provës i pandehur ishte Armando Fuat Shkurti, dhe jo Thoma Nikollaj Shkurti, dhe për rrjedhojë, as ky i fundit, as mbrojtësi i tij nuk mund të ishin të pranishëm në seancën gjyqësore për sigurimin e provës. I pranishëm në seancën e sigurimit të provës ishte mbrojtësi i caktuar kryesisht për Armando Shkurтин. Vendimi për sigurimin e provës së dëshmisë së shtetasës L.A. kundër kërkuesit, nuk u apelua brenda afatit në gjykatën e apelit dhe rrjedhimisht ai mori formë të prerë. Në seancat gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Fier dhe Gjykatën e Apelit Vlorë mbrojtësi i kërkuesit pati mundësi që të paraqesë kundërshtimet mbi thëniet e deklaruara nga dëshmitarja, si edhe të parashtrojë kërkesa për realizimin e mbrojtjes së të pandehurit gjatë gjithë procesit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Gjykatat kanë dëgjuar edhe dëshmitarët e kërkuar nga avokati i kërkuesit dhe kanë vlerësuar, në cilësinë e provës, shkresa të ndryshme të paraqitura nga prokuroria. Kërkuesi ka pasur mundësi që të bënte deklarin e tij para gjykatave të zakonshme, ndonëse ka zgjedhur që këtë gjë ta bënte përmes avokatit mbrojtës, pasi gjykimi është kryer në mungesë të kërkuesit. Sipas kërkesës së avokatit mbrojtës të kërkuesit, përveç dëshmisë së administruar në seancën gjyqësore për sigurimin e provës, gjykatat kanë vlerësuar dëshmitë e shtetasve F.A., P.G., M.A. dhe Xh.A. të kërkuar edhe nga mbrojtja, si dhe disa dokumente shkresore, të cilat, sipas gjykatave të zakonshme, mbështesin deklarinet e bëra nga L.A. dhe u kanë krijuar gjykatave bindjen e brendshme që deklarinet e L.A. ishin të vërteta. Gjykata çmon se kërkesa për ballafaqim nuk është pranuar nga gjykatat e zakonshme, pasi ato nuk janë bindur në nevojën e një ballafaqimi të tillë, veçanërisht duke pasur parasysh që një nga të akuzuarit në proces ishte babai i shtetasës L.A. dhe ballafaqimi kërkohej, ndër të tjera, me nënën dhe motrën e saj. Gjykatat e mësipërme, megjithatë, personat me të cilët mbrojtja kërkonte të bënte ballafaqimin, i kanë thirrur si dëshmitarë dhe thëniet e tyre janë regjistruar në procesverbalin e seancës gjyqësore.

Për sa më sipër, Gjykata çmon se, në tërësi, procesi ndaj kërkuesit nuk ka qenë i parregullt. Kërkuesi ka pasur një mundësi të përshtatshme dhe të vërtetë, që gjatë deklarin të tij ose gjatë gjithë fazave të procesit gjyqësor të kundërshtonte akuzën kundër tij, të ngritur nga prokurori i çështjes.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e pabazuar, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së dhe për rrjedhojë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (Kryetar), Gjergj Sauli, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi, Vitore Tusha.

Anëtarë kundër: Fehmi Abdiu, Kujtim Puto, Sokol Berberi.

VENDIM

Nr.1, datë 27.3.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Artan Hoxha	Anëtar
Gani Dizdari	Anëtar
Nikoleta Kita	Anëtare
Agron Lamaj	Anëtar
Spiro Spiro	Anëtar
Perikli Zaharia	Anëtar
Evjeni Sinoimeri	Anëtare
Irma Bala	Anëtare
Shpresa Beçaj	Anëtare
Fatos Lulo	Anëtar
Besnik Imeraj	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 27.3.2008, mori në shqyrtim çështjen penale me:

TË GJYKUAR: Emiljano Zerellari.

AKUZUAR: Për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr.208, datë 28.12.2005, ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Emiljano Zerellari për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim.

- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, e dënon përfundimisht me 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.89, datë 10.3.2006, ka vendosur:

- Prishjen e vendimit nr.208, datë 28.12.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Berat dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr.125, datë 28.9.2006, ka vendosur:

- Pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Emiljano Zerellari, akuzuar për veprën penale të prodhimit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, pasi ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë dhe mbajtja e lëndës narkotike ka qenë për përdorim vetjak dhe në sasi të vogla.

- Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit Emiljano Zerellari, nëse nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.517, datë 26.12.2006, ka vendosur:

- Ndryshimin e vendimit nr.125, datë 28.9.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe

duke e gjykuar çështjen në fakt.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Emiljano Zerellari për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë **ka paraqitur rekurs i gjykuari Emiljano Zerellari**, nëpërmjet avokatit të tij, i cili ka kërkuar prishjen e tij dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke parashtruar këto shkaqe:

1. Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është rezultat i zbatimit të keq të nenit 283/1 të Kodit Penal, pasi veprimet e kryera nga i pandehuri nuk përbëjnë elemente të veprës penale, meqenëse ai ka mbajtur një sasi lëndë narkotike prej 1,9 gram, që është dozë për përdorim vetjak, është përdorues i rregullt i lëndës narkotike, prandaj dhe ligjvënësi ka përjashtuar nga përgjegjësia penale përdoruesit që mbajnë doza të vogla.

2. Meqenëse në ligj nuk është përcaktuar se sa mund të jetë sasia për përdorim vetjak që përjashtohet nga përgjegjësia penale, gjykata duhet të mbante parasysh faktin se i pandehuri është përdorues prej 3-4 vjetësh i heroinës, është shtruar dhe në Spitalin Ushtarak dhe ka marrë mjekim të specializuar për t'u shëruar nga kjo sëmundje, por nuk ia ka arritur dhe ka vazhduar ta përdorë rregullisht lëndën narkotike.

3. Përdërisa, sipas mendimit të ekspertit, dozat përdoren të gjitha nga i pandehuri brenda ditës, duke mos qenë fillestar si përdorues i lëndës narkotike, për më tepër që, dhe në raste analoge, gjykata e apelit ka përjashtuar nga dënimi persona të cilëve i janë gjetur doza deri në 2 gram lëndë narkotike, siç është rasti i shtetasit Artan Hoxha nga Berati, edhe në rastin konkret gjykata e apelit duhet të kishte lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, dhe jo ta ndryshonte atë duke deklaruar fajtor të pandehurin Emiljano Zerellari, për më tepër që dhe mosha e të pandehurve në të dy rastet është e ngjashme.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke çmuar se dispozita e nenit 283/1 të Kodit Penal është zbatuar dhe interpretuar në mënyrë të ndryshme nga gjykatat e faktit, si dhe vetë Kolegji Penal ka mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me kuptimin që ka shprehja "... përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla ...", vendosi që ta kalojë çështjen në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të unifikuar praktikën gjyqësore lidhur me:

1. Mbi cilat kritere duhet të bazohet gjykata për të përcaktuar nëse bëhet fjalë për "dozë të vogël" dhe a mund të përcaktohet konkretisht sasia maksimale e lëndës narkotike që do të konsiderohet "dozë e vogël"?

2. Kur doza çmohet jo e vogël, por mjekët e konsiderojnë për përdorim vetjak ditor, a do konsiderohet mbajtja e saj si "për përdorim vetjak"?

3. Sasia e lëndës narkotike, që përjashton nga dënimi personin, për shkak të faktit që e ka për përdorim vetjak, a duhet të ndryshojë në lidhje me llojin e lëndës narkotike?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e gjyqtarëve Besnik Imeraj dhe Spiro Spiro, prokurorin pranë Gjykatës së Lartë, Artur Selmani, i cili kërko lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, avokatin Shuaip Syri, që kërko prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Shkallës së Parë Berat, si dhe pasi shqyrtoi në tërësi çështjen,

VËREJNË:

Se i gjykuari Emiljano Zarellari u arrestua në flagrancë, pasi më 22.9.2005 është kapur me 1,9 gr. pluhur, të ndarë në gjashtë qese. Rezultoi e provuar që lënda përmbante heroinë, acetilkodeinë, monoacetilmorfinë, substanca këto, të cilat bëjnë pjesë në grupin e lëndëve narkotike. Sipas aktit të

ekspertimit toksikologjik, në urinën e të pandehurit u zbulua prania e po këtyre substancave.

Rezultoi, gjithashtu, i provuar fakti që i gjykuari Emiljano ishte përdorues që prej 4 vjetësh i lëndëve narkotike, kurse, sipas specialistit të thirrur si ekspert, sasia e lëndës narkotike që iu kap atij ishte e mjaftueshme për t'u përdorur prej tij, brenda 24 orëve.

Gjykata e Rrethit Berat, me argumentin se doza e gjetur të gjykuarit ishte për përdorim vetjak dhe se nuk provohej që ai të ishte shpërndarës i saj, e ka deklaruar të gjykuarin të pafajshëm. Kurse Gjykata e Apelit Vlorë, me arsyetimin se lënda e gjetur të gjykuarit ishte në sasi jo të vogël, edhe pse ai e kishte për përdorim vetjak, ndryshoi vendimin e mësipërm, duke e deklaruar fajtor dhe dënuar të gjykuarin për krimin e parashikuar në nenin 283/1 të Kodit Penal, vendim ky për të cilin Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arritën në përfundimin se është i drejtë, i bazuar në ligj.

Gjatë shqyrtimit të pretendimeve që përmban rekursi i të gjykuarit Emiljano dhe në funksion të zgjidhjes së çështjes penale, objekt shqyrtimi në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, këto Kolegje vunë në bisedim edhe problemet për të cilat Kolegji Penal e kaloi çështjen penale për njësim të praktikës gjyqësore, për të cilat arriti në përfundimet e mëposhtme.

Krimi i prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike, që parashikohet në nenin 283 të Kodit Penal (me paragrafin e parë të të cilit është deklaruar fajtor e dënuar i gjykuari Emiljano), përveç shitjes, ofrimit për shitje, marrjes në çdo formë, shpërndarjes, tregtimit, transportimit, dërgimit dhe dorëzimit të substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, nga ana objektive, kryhet edhe në formën e mbajtjes së këtyre lëndëve, substancave e farërave, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre. Lidhur me këtë formë (mbajtjen) të anës objektive të kësaj figure krimi, ligjvënësi, si kriter përcaktues për ekzistencën e vetë figurës së krimit dhe, për pasojë, të bazës së përgjegjësisë penale për personat që e konsumojnë atë, ka parashikuar dy rrethana specifike: së pari, mbajtjen e substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe të farëve të bimëve narkotike jo për përdorim vetjak dhe së dyti, edhe kur rezultoi i provuar fakti që këto lëndë mbahen nga personi për përdorim vetjak, në aspektin sasior, ato nuk duhet të jenë në doza të vogla.

Përsa i përket rrethanës së parë, Kolegjet vënë në dukje se ajo është rrethanë fakti - rezultat i procesit të të provuarit nëpërmjet analizës, në zbatim të kërkesave të dispozitës së nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, të provave dhe indicieve, në të cilat duhet të bazohet gjykata për të arritur në përfundime të drejta, nëse lënda narkotike dhe psikotrope, etj. mbahet nga personi për përdorim vetjak apo për të kryer në vijim, (pavarësisht se kur), ndonjërin apo disa nga veprimet e tjera (shitje, ofrim për shitje, dhënie ose marrje në çdo formë, shpërndarje, tregtim, transportim, dërgim dhe dorëzim të saj), që janë elemente të anës objektive të figurës së krimit të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve.

E veçanta e rrethanës së "... përdorimit vetjak" është se ajo nuk qëndron më vete. Ajo nuk mund të shërbejë e vetme, për të arritur në përfundimin se, duke u bazuar vetëm në ekzistencën e saj (të faktit të provuar tashmë, sipas të cilit lënda narkotike dhe psikotrope, etj. mbahet për përdorim vetjak), nuk ekziston edhe figura e krimit të parashikuar në nenin 283 të Kodit Penal. Kësisoj, ajo nuk mund të shërbejë e vetme për të arritur në përfundimin se nuk ekziston baza ligjore (figura e krimit) për të marrë mbajtësin e tyre në përgjegjësi penale. Përkundrazi, për të mos u marrë mbajtësi i lëndëve të tilla në përgjegjësi penale duhet të provohet se ekziston edhe rrethana e dytë, që ka lidhje me sasinë e këtyre lëndëve, e cila, sikurse shprehet ligjvënësi në vetë dispozitën e përmendur, duhet të jetë "në doza të vogla".

Nocioni juridiko-penal që është shprehur nga ligjvënësi me togfjalëshin "në doza të vogla", edhe pse nuk mund të bëhet ndonjë përcaktim numerik i sasisë së lëndëve të ndaluara që do të shprehte në peshë sasinë e dozës për t'u konsideruar e vogël, duhet të interpretohet në kuptimin që, në aspektin sasior, lënda narkotike dhe psikotrope etj., duhet të jetë në atë masë sa të konsiderohet realisht e vogël për përdorim vetjak nga ana e individit konkret, dhe jo në përgjithësi. Ajo nuk duhet të tejkalojë aftësitë fiziko-biologjike të individit përdorues dhe brenda kufijve të tolerancës që paraqet organizmi i tij për llojin konkret të lëndës narkotike, në momentin dhe kushtet e përdorimit të kësaj lënde, për të mos krijuar tek ai efekte tej asaj shkalle që do t'i dëmtonin shëndetin. Marrë për bazë këtë analizë, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: **"Doza e vogël, në kuptimin ligjor të saj, konsiderohet jo ndarja fizike në disa të tilla, por sasia e lëndës apo substancës narkotike e**

psikotrope që ajo përmban si e tërë dhe që sipas ekspertëve vlerësohet si dozë e vogël.”.

Përcaktim i tillë i nocionit “në doza të vogla”, për efekte të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të Kodit Penal, veç rrolit parandalues që luan për ruajtjen e shëndetit të përdoruesve dhe personave që kanë vartësi nga droga, luan dhe rrolin e parandalimit të përgjithshëm në drejtim të luftës kundër fenomenit të përdorimit të kundërligjshëm të këtyre lëndëve, i cili ku gjen përhapje në përmasa të mëdha, shndërrohet në patologji sociale. Në kushtet kur tek ne ende nuk janë përcaktuar, me ligj të posaçëm apo me akte nënligjore, rastet e përdorimit të lëndëve narkotike dhe psikotrope “në përputhje me ligjin dhe jo në kapërcim të tyre” (nevojë kjo për të cilën Kolegjet e Bashkuara çmojnë se diktohet nga vetë mënyra se si është formuluar dispozita e sipërpërmendur), përcaktimi si më sipër i nocionit juridiko-penal “në doza të vogla” shërben edhe për ngushtimin, në një masë të arsyeshme, të hapësirave, shfrytëzimi i të cilave, në forma të padrejta, nga keqbërësit, do të ndikonte në shmangien pa të drejtë nga përgjegjësia penale të përdoruesve të lëndëve narkotike dhe psikotrope, të cilët shpesh konstatohet se janë edhe shpërndarës të këtyre lëndëve.

Për shkak të njohurive të posaçme që kërkojnë në fushën e toksikologjisë, gjykata, për zgjidhjen e çështjes që lidhet me sasinë e lëndës narkotike të nevojshme për përdorim vetjak, duhet të thërrasë në çdo rast specialistë të fushës, si toksikologë apo mjekë terapistë, mendimi shkencor i të cilëve do të shërbejë si njëri prej kriterëve ku ajo do të mbështesë arsyetimin e vendimit të saj.

Por, për zgjidhjen përfundimisht të çështjes, gjykata duhet të mbështetet edhe në kriterin tjetër, me të cilin lidhet ngushtësisht ai i pari, kriter ky që konkretizohet nëpërmjet sqarimit të rrethanave faktike të mbajtjes së sasisë konkrete të lëndës narkotike apo psikotrope nga personi konkret (pikërisht në momentin e gjetjes së saj tek ose pranë tij), nëpërmjet zbatimit të kërkesave ligjore të Kodit të Procedurës Penale, që vlejnë për realizimin me sukses të procesit të të provuarit, në përgjithësi.

Bazuar në sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se: **“Përdoruesi i lëndëve narkotike, i cili e mban atë jo për përdorim vetjak, qoftë edhe në doza të vogla, kur është shpërndarës i saj në një nga format që parashikon neni 283/1 i Kodit Penal, ka përgjegjësi penale sipas kësaj dispozite. Çmojnë gjithashtu se përcaktimi i dozës së vogël të lëndës narkotike e psikotrope, për efekt të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të Kodit Penal, duhet të bëhet me ndihmën e specialistëve të fushës (toksikologë etj.), të thirrur si ekspertë dhe rast pas rasti, jo vetëm sipas llojit të lëndës narkotike e psikotrope, por edhe të cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së vartësisë nga droga të personit konkret-mbajtës i lëndës narkotike dhe psikotrope.”.**

Duke i dhënë kuptimin, si më sipër, togfjalëshit “për përdorim vetjak dhe në doza të vogla”, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se në këtë mënyrë jo vetëm që gjen zbatim të drejtë dispozita e nenit 283 të Kodit Penal që e përmban atë, por, në të njëjtën kohë, japin edhe kontributin e tyre në drejtim të kuptimit jo si një e drejtë e pakushtëzuar të përjashtimit të përdoruesve në sasi relativisht të vogla të lëndëve narkotike e psikotrope nga përgjegjësia penale. E kundërta do t’u krijonte hapësira ligjore dhe mundësi praktike më të shumta individëve, të cilët, të kamufluar pas termit formalo-juridik “doza të vogla”, t’i shmangeshin, pa të drejtë, përgjegjësisë penale, për mbajtjen e tyre.

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, referuar akteve dhe përfundimeve të gjykatës në çështjen në shqyrtim, rezulton se i gjykuari Emiljano Zerellari, në momentin që është arrestuar nga policia ka pasur në posedim 1.9 gram lëndë narkotike të llojit “heroinë”, të ndarë në gjashtë paketa, me afërsisht 0.31 gram secila. Sipas përfundimeve të ekspertëve, sasia prej 1.9 gram e kësaj lënde shërben për përdorim ditor për të gjykuarin, duke krahasuar nivelin e lëndës narkotike që atij i është gjendur në analizën e urinës. Por sipas mendimit të ekspertëve, e gjithë kjo sasi nuk është vetëm për një përdorim, por për disa të tilla dhe gjatë gjithë ditës, dukë bërë kështu të kuptohet se Emiljano Zerellari ka pasur në dispozicion, në momentin e ndalimit, disa doza të vogla dhe për disa përdorime gjatë 24 orëve. Ky fakt, referuar interpretimit të dispozitës së nenit 283/1 të Kodit Penal dhe të unifikuar sipas këtij vendimi të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çon në përfundimin se Emiljano Zarellari e ka kryer veprën penale të mbajtjes së lëndëve narkotike, sikurse ka pranuar Gjykata e Apelit Vlorë në vendimin e saj, për shkak se ai ka tejkaluar dozën e vogël të mbajtjes për përdorim, që parashikon dispozita e nenit 283/1 të Kodit Penal.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 438 e 441/a të Kodit të Procedurës

Penale,

VENDOSËN:

- Lënien në fuqi të vendimit nr.517, datë 26.12.2006 të Gjykatës së Apelit Vlorë.
- Unifikimin e praktikës gjyqësore sikurse përcaktohet në këtë vendim.
- Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi që njeson praktikën gjyqësore.

VENDIM
Nr.110, datë 16.9.2008

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENPOWER ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E
NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME
ERË, SI DHE TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PARQET EOlike
KARABURUN DHE LLOGARA

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pika 1, germa “a”, 8, si dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, 13, si dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.9.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike,

konstatoi se:

1. Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të “Enpower Albania” sh.p.k. ka nisur me marrjen e vendimit nr.64, datë 27.11.2007.
2. Me vendim nr.30, datë 4.3.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s miratoi kërkesën e shoqërisë për shtyrjen e vendimmarrjes.
3. Ligji nr.9913, datë 5.5.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” nuk parashikon të ketë fuqi prapavepruese për aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Në lidhje me ndërtimin e këtij parku, shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., aplikimin e saj për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike, e bazon studimin e prefisibilitetit në të dhëna historike të regjistruara të erës, të matura në lartësi të ndryshme nga ato në të cilat do të punojnë gjeneratorët.

5. Ligji për sektorin e energjisë elektrike parashikon në nenin 15 autoritetin e ERE-s për vendosjen e kushteve të çdo licence.

Për sa konstatuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Enpower Albania” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara, me kusht zbatimin, përveç sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimin të energjisë elektrike, edhe të zbatimit të kushteve të mëposhtme:

a) Kryerjen e një studimi fisibiliteti, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim i kostos së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE brenda 12 muajve nga data e lëshimit të licencës dhe përpara fillimit të zbatimit të punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve.

b) Shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k. duhet paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga kodi i transmetimit.

c) Shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k. do të respektojë detyrimet e shërbimit publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

d) Koha e zbatimit e të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu referuar datës së lëshimit të licencës, të jetë 36 muaj.

e) Mospërbushja e pikave të mësipërme në afatet e përcaktuara e bën licencën të pavlefshme.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.111, datë 16.9. 2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GEN-I TIRANA” SHPK PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT TË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pikat 1, germa “d”, dhe 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1 germa “d”, dhe 10, të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, dhe nenit 18 pikat 1 germa “a”, dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.9.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gen-I Tirana” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi:

1. Paraqitjen e plotë të dokumentacionit sipas rregullores për procedurat e licencimit, nga shoqëria “Gen-I Tirana” më datë 4.9.2008 për licencimin për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike.

2. Rregullorja për procedurat e licencimit, e miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, në nenin 20 parashikon se për të gjitha aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të aplikohen rregullat e përcaktuara në rregulloren e procedurave të licencimit të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Gen-I Tirana” sh.p.k. për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.112, datë 16.9.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GEN-I TIRANA”
SHPK PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT TË FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR

Në mbështetje të neneve 9 dhe 45, pikat 4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1 germa “d”, dhe 10 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, dhe nenit 18 pikat 1, germa “a”, dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.9.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gen-I Tirana” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi:

1. Paraqitjen e plotë të dokumentacionit sipas rregullores për procedurat e licencimit, nga shoqëria “Gen –I Tirana” në datën 4.9.2008 për licencimin për kryerjen e aktivitetit të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Rregullorja për procedurat e licencimit, e miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, në nenin 20 parashikon se për të gjitha aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të aplikohen rregullat e përcaktuara në rregulloren e procedurave të licencimit të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Gen-I Tirana” sh.p.k. për kryerjen e

aktivitetit të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

KËRKESË

Nr.5343/14, datë 15.9.2008

PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit: tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe kulturave bujqësore, që preken nga “Ndërtimi i nënstacionit 400/220/110 KV Kashar”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është: “Operatori i sistemit të transmetimit” sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve pas publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT ELEKTRIK 400/220/110 Kv Kashar
RRETHI: TIRANË

KOMUNA: KASHAR

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: arë, truall, banesë ndërtimi industrial.

Lloji i pasurisë që dëmtohet për shkak të ndërtimit:kultura bujqësore, të mbjella, strukturë vreshti, ullinj.

OBJEKTI	Shpronësimi definitiv									Shpronësim provizor				Vlera total e kompensimit në lekë	Adresa e pronarit
	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. pasurisë	Sasia shpronësim definitiv m²	Çmimi shitje ZRPP lek/m²	Vlera kompensimit	Sasia në m²	Lloji i kulturës bujqësore	Vlera në lekë për /ha	Vlera në lekë për kulturën		
nst 400	Bedri	Fiqiri	Murati	Arë	2105	24/17	1,700	2500	4,250,000	1,700	jonxhe	71,000	12070	4,262,070	Kashar
nst 400		Fiqiri	Ibrahim			24/18	1,613	2500	4,032,500	1,613	jonxhe	70,000	11291	4,043,791	Kashar
nst 400	Bajram	Mustafa	Sula	Arë	2105	24/8	3308	2500	8,270,000	3308	jonxhe	71,000	23486.8	8,293,487	Kashar
rruga	Bajram	Mustafa	Sula	Arë	2105	24/1	491	2500	1,227,500	491	jonxhe	71,000	3486.1	1,230,986	Kashar
nst 400	Hamza	Sali	Dema	Arë	2105	24/9	9042	2500	22,605,000	9042	jonxhe	69,000	62,390	22,667,390	Kashar
nst 400	Skender	Sali	Dema												Kashar
nst 400	Petrit	Sali	Dema												Kashar
nst 400	Ymer	Ymer	Sula												Kashar
nst 400	Xhemal	Ymer	Sula												Kashar
nst 400	Osman	Ymer	Sula												Kashar
nst 400	Latif	Ymer	Sula												Kashar
nst 400	Zija	Rexhep	Hoxha	Arë	2105	24/15	2050	2500	5,125,000	2050	ndrysh.	75,000	15,375	5,140,375	Kashar
nst 400	Zija	Rexhep	Hoxha	Arë	2105	24/16	3994	2500	9,985,000	3994	ndrysh.	115,000	45,931	10,030,931	Kashar
nst 400	Vait		Hoxha	Arë	2105	24/15									Kashar
nst 400	Shygyri	Hasan	Hoxha	Arë	2105	24/13	3447	2500	8,617,500	3447	jonxhe	72,000	24,818	8,642,318	Kashar
nst 400	Jemin	Ramazan	Hoxha	Arë	2105	24/20	5062	2500	12,655,000	5062	ndrysh.	110,000	55,682	12,710,682	Kashar
nst 400	Jemin	Ramazan	Hoxha	Truall	2105	24/7	275	12857	3,535,675	275	ndrysh.	110,000	3,025	3,538,700	Kashar
nst 400	Myrteza	Ramazan	Hoxha	Arë	2105	24/19	5000	2500	12,500,000	5000	jonxhe	69,000	34,500	12,534,500	Kashar
nst 400	Kalem	Ramazan	Hoxha	Arë	2105	24/12	3375	2500	8,437,500	3375	jonxhe	71,000	23,963	8,461,463	Kashar
nst 400	Kalem	Ramazan	Hoxha	Arë	2105	26/5	2125	2500	5,312,500	2125	jonxhe	71,000	15,088	5,327,588	Kashar
nst 400	Sadiq	Ramazan	Hoxha	Arë	2105	26/6	5375	2500	13,437,500	5375	jonxhe	70,000	37,625	13,475,125	Kashar

nst 400	Arben	Daut	Shehu	Are	2105	26/2/2	1006	2500	2,515,000	1006	hasell	55,000	5,533	2,520,533	Kashar
nst 400	Gezim	Hysen	Smaqi	Are	2105	26/2/1	627	2500	1,567,500	627	hasell	62,000	3,887	1,571,387	Kashar
nst 400	Lutfi	Qamil	Hoxha	Are	2105	32/4	779	2500	1,947,500	779	jonxhe	71,000	5,531	1,953,031	Kashar
nst 400	Veiz	Jashar	Dema	Are	2105	32/3	4500	2500	11,250,000	4500	ndrysh.	112,000	50400	11,300,400	Kashar
nst 400	Halim	Qazim	Dema	Are	2105	32/2	3375	2500	8,437,500	3375	ndrysh.	63,000	21,263	8,458,763	Kashar
nst 400	Halim	Zyber	Dema	Are	2105	32/1	6406	2500	16,015,000	6406	jonxhe	72,000	46,123	16,061,123	Kashar
nst 400	Xhavit	Xhemal	Hoxha	Are	2105	33/1	1170	2500	2,925,000	1170	ndrysh.	100,000	11,700	2,936,700	Kashar
nst 400	Halim	Zyber	Dema	Are	2105	33/2	675	2500	1,687,500	675	jonxhe	72,000	4,860	1,692,360	Kashar
nst 400	Agim	Abdulla	Dema	Are	2105	33/3	588	2500	1,470,000	588	perime	120,000	7,056	1,477,056	Kashar
nst 400	Bedri	Ibrahim	Murati	Are	2105	25/3	2600	2500	6,500,000	2600	jonxhe	70,000	18,200	6,518,200	Kashar
nst 400	Fiqiri	Ibrahim	Murati	Are	2105	25/4	1400	2500	3,500,000	1400	jonxhe	70,000	9,800	3,509,800	Kashar
nst 400	Iilir	Bajram	Nurce	Truall	2105	25/2	2100	12857	26,999,700	0			0	26,999,700	Kashar
nst 400	Iilir	Bajram	Nurce	ndertim	2105	25/2	1371	45500	62,380,500	0			0	62,380,500	Kashar
nst 400	Rakip	Haxhi	Dema	Are	2105	26/4/2	791	2500	1,977,500	791	ndrysh.	74,000	5,853	1,983,353	Kashar
nst 400	Abdyl	Haxhi	Dema	Are	2105	26/4/3	1123	2500	2,807,500	1123	hasell	64,000	7,187	2,814,687	Kashar
nst 400	Jakup	Ahmet	Sula	Are	2105	26/4/4/6	457	2500	1,142,500	457	ndrysh.	105,000	4,799	1,147,299	Kashar
nst 400	Pa emer			Are	2105	26/4/4/5	2460	2500	6,150,000	2460	jonxhe	65,000	15,990	6,165,990	Kashar
nst 400	Behar	Shefqet	Sula	Are	2105	11	614	2500	1,535,000	614	jonxhe	74,000	4,544	1,539,544	Kashar
nst 400	Xhemal	Haxhi	Dema	Are	2105	26/4/1	470	2500	1,175,000	470	hasell	63,000	2,961	1,177,961	Kashar
nst 400	Pa emer			Are	2105	1120/1	769	2500	1,922,500	796	hasell	66,000	5,254	1,927,754	Kashar
nst 400	Petrit	Ibrahim	Valisi	Are	2105	1120/22	549	2500	1,372,500	549	ndrysh.	69,000	3,788	1,376,288	Kashar
nst 400	Ylvi	Hasan	Murati	Are	2105	118/6	185	2500	462,500	185	jonxhe	68,000	1,258	463,758	Kashar
nst 400	Pa emer			Are	2105	118/7	158	2500	395,000	158	jonxhe	68,000	1,074	396,074	Kashar
nst 400	Pa emer			Are	2105	1118/1	281	2500	702,500	281	jonxhe	69,000	1,939	704,439	Kashar
nst 400	Muhamet	Qerim	Sula	Are	2105	1118/2	123	2500	307,500	123	jonxhe	69,000	849	308,349	Kashar
nst 400	Sadik	Ramazan	Hoxha	shtepi	2105	26/6	113.6	41500	4,714,400	113.6	-	0	0	4,714,400	Kashar
nst 400	Njazi	Sadik	Hoxha	shtepi	2105	26/6	120	41500	4,980,000	120	-	0	0	4,980,000	Kashar
nst 400	Rasim	Jemin	Hoxha	shtepi	2105	24/20	74	41500	3,071,000	74	-	0	0	3,071,000	Kashar
nst 400	pretendim	pronesie			2105	119,etj	18,348	2500	45,870,000	13504			0	45,870,000	Kashar

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 24.9.2008
Doli nga shtypi më 24.9.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 32 lekë